



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 12.08.2026

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje e mjeteve didaktike për pajisjen e institucioneve të arsimit parashkollor/kopshteve në territorin e Bashkisë Durrës”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Pajisjet për mësimdhënie 39162100-6.

VLERA E FONDIT LIMIT:

4,182,938 (katër milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë) Lek pa TVSH, vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Durrës 2026-2028.

Afati i lëvrimit të mallit: *30 (tridhjetë) ditë, nga dita e nënshkrimit të kontratës.*

Argumentimi:

Në mbështetje të nenit 21, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të nenit 2, pika 2, shkronja “c”, dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në zbatim të urdhrin nr.228, datë 10.06.2026, me nr.8009 prot., të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për ngritjen e grupit të punës përgjegjës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, grupi i punës hartoi procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

- Gupi i punës, pasi u njoh me objektin e prokurimit të parashikuar në buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë Durrës, në kuadër të prokurimit publik zhvilloi veprimtarinë e tij mbi bazën e dy drejtimeve kryesore:
 - a. Përcaktimi i specifikimeve teknike** për mallrat që do të prokurohen, përmes grumbullimit dhe analizimit të informacionit të nevojshëm;
 - b. Studimi i tregut dhe përllogaritja e vlerës limit të kontratës**, në përputhje me burimet dhe metodologjinë e parashikuar në legjislacionin për prokurimin publik.

I. PERCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE;

Në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë elementet më të rëndësishme të mallrave, të cilat garantojnë cilësinë dhe përshtatshmërinë e tyre për funksionet e kërkuara.

Për sigurimin e informacionit të nevojshëm, grupi i punës i dërgoi Operatorit të Blerjeve të Përqendruara (OBP) shkresën nr.8009/1 prot., datë 07.07.2026, me objekt marrjen e informacionit mbi specifikimet teknike dhe çmimet referencë zyrtare për mallra të njëjta ose të ngjashme me ato objekt prokurimi. Në përgjigjen e kthyer me shkresën nr.3805/1 prot., datë 09.07.2026, OBP-ja sqaroi se, për artikujt e kërkuar, nuk disponon katalog standardesh.

Në vijim, grupi i punës hartoi, unifikoi dhe standardizoi specifikimet teknike, duke u mbështetur në nevojat konkrete të autoritetit kontraktor, funksionet që duhet të përmbushin mallrat dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi, me qëllim garantimin e qartësisë dhe objektivitetit të procedurës së prokurimit.

***Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenit 36 të LPP, nenit 2 c), 12, 13 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.*

II. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të nenit 76 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, për përllogaritjen e vlerës limit autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë prej alternativave të mëposhtme:

- a) çmimeve të publikuara nga INSTAT-i ose çmimeve të tjera zyrtare;
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra;
- c) çmimeve të kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë autoriteti kontraktor ose nga autoritete të tjera kontraktore;
- ç) çmimeve ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Në zbatim të këtyre parashikimeve, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

Instituti të Statistikave (INSTAT) iu dërgua shkresa nr.8009/2 prot., datë 07.07.2026, me objekt marrjen e informacionit mbi çmimet e publikuara për mallra të njëjta ose të ngjashme me ato objekt prokurimi. Në përgjigjen e kthyer, INSTAT-i sqaroi se nuk disponon të dhëna të detajuara për çmimet e kategorisë përkatëse të mallrave.

Sektorit të Prokurimeve Publike në Bashkinë Durrës iu dërgua shkresa nr.8009/3 prot., datë 07.07.2026, me qëllim verifikimin e ekzistencës së kontratave të mëparshme për mallra të njëjta ose të ngjashme. Nga verifikimi i kryer rezultoi se nuk kishte praktika të mëparshme prokurimi për këtë kategori mallrash.

Për sa më sipër, në mungesë të të dhënave zyrtare dhe të praktikave të mëparshme për mallra të njëjta ose të ngjashme, grupi i punës vijoi me testimin e tregut, duke administruar ofertat e paraqitura nga tre operatorë ekonomikë, të dhënat dhe elementët e çmimeve të të cilëve ndodhen të administruar në dosje.

Ofertat e administruara u shqyrtuan, u analizuan dhe u pasqyruan në tabelën përmbledhëse, e cila, së bashku me ofertat përkatëse, është pjesë përbërëse e këtij procesverballi. Për secilin artikull u përllogarit çmimi mesatar i ofertave të paraqitura. Më pas, çmimi mesatar për njësi u shumëzua me sasinë e kërkuar për secilin artikull, ndërsa shuma e vlerave të përllogaritura shërbeu për përcaktimin e fondit limit të kontratës.

Metodologjia e ndjekur mbështetet në nenet 12 dhe 13, si dhe në nenin 76, pikat 1 dhe 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Në përfundim, si rezultat i mbledhjes së të dhënave të sipërnxjerrë, rezultoi se, vlera e përgjithshme e kontratës rezulton të jetë: 4,182,938 (*katër milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë*) Lek pa TVSH,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”, si dhe në përputhje me Dokumentet e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr.08, datë 23.09.2024.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, të *shtojcës 8*. (Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas *Shtojcës 9*.)

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 pika 2, germa c) e 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 3, ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhetë lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qenë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës. Kërkesa është në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues

ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”; Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar; kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, siguron qëndrueshmëri financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument, të lëshuar nga administrata e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ushtrojnë aktivitetin, që vërteton se kanë shlyer detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2025, si dhe këstet e maturuara për vitin 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe akteve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Ky dokument duhet të dorëzohet në sistem gjatë fazës së ofertimit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë këtë vërtetim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, në nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025, përfshirë këstet e maturuara të vitit 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 74 të tij. Shlyerja e detyrimeve vendore siguron që operatori ekonomik të jetë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të mos ketë detyrime të prapambetura ndaj administratës vendore.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një procedure publike, ku përzgjedhja e operatorit duhet të garantojë integritet të plotë financiar dhe administrativ. Ky kriter është ligjërisht i bazuar, i

arsyeshëm dhe në përputhje me parimet e integritetit dhe kontrollit fiskal që kërkohen për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në kontrata publike, duke siguruar që subjektet pjesëmarrëse të jenë kontribuues aktivë dhe të ndershëm në sistemin tatimor e vendor të Republikës së Shqipërisë.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 germa b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar me cilësi kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Aftësitë teknike dhe profesionale të tjerat si më poshtë janë hartuar, vendosur dhe përlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit”, në zbatim të urdhrin nr.228, datë 10.06.2026, me nr.8009 prot., të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, mbështetur në Vendimin të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Argumentim i përgjithshëm: Kriteret teknike të kualifikimit janë hartuar në përputhje të plotë me kërkesat specifike të përcaktuara me ligj: Direktivën 2009/48/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 18.06.2009, “Për sigurinë e lodrave”, të ndryshuar; Ligjin nr. 10 480, datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, të ndryshuar; Ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar; VKM-në nr. 262, datë 03.04.2013, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për sigurinë e lodrave’”.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon 1 (një) automjet qe do te shërbejë për transportin e produkteve objekt prokurimi, ne pronësi ose ne përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon 1 (një) automjet, në pronësi ose në përdorim/ me qira sipas kontrates noteriale, te vërtetuar me:

- leje qarkullimi,
- siguracion (TPL),
- certifikatë e kontrollit teknik.

Në rastin kur automjeti është me qira/në përdorim, të paraqesë kontratën noteriale përkatëse si dhe dokumentet e kërkuara të automjetit.

Argumentim: *Kërkesa që OE të disponojë një automjet me masë maksimale të autorizuar jo më shumë se 3.5 ton, është vendosur pasi lëvrimi i mallit pranë magazinës të AK do të kryhet menjëherë për gjithë sasinë e artikujve, përse më sipër AK nëpërmjet këtij kriteri do të sigurohet që OE ka kapacitet për të përmbushur nevojat e AK brenda afatit të përcaktuar në grafikon e lëvrimit..*

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë SSH EN ISO 9001:2015 lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë të produkteve, ose ekuivalente, të vlefshme, për prodhimin dhe/ose tregtimin e produkteve objekt prokurimi.

Argumentimi: *Kërkesa për certifikatën SSH EN ISO 9001:2015, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë të produkteve, ose ekuivalente, të vlefshme, për prodhimin dhe/ose tregtimin e produkteve objekt prokurimi, është vendosur nga AK, pasi kërkon të sigurohet që OE konkurues plotëson kërkesat dhe standardet për menaxhimin e cilësisë së produkteve që ai tregon.*

2.4.2 OE, për çdo lodër, duhet të paraqesë “Deklaratë CE të Konformitetit”, në përputhje me standardet e CE. Deklarata e konformitetit identifikon artikullin për të cilën kjo deklaratë është hartuar. Në deklaratën e konformitetit të paraqitur duhet të duket qartazi lidhja e produktit të paraqitur, me deklaratën e konformitetit.

Argumentimi: *Kërkesa që OE, të paraqesë një deklaratën e konformitetit për secilën lodër, është vendosur në përputhje me Direktivën 2009/48/EC (e përditësuar) të Parlamentit Evropian, adaptuar në legjislacionin shqiptar sipas VKM nr. 262, datë 03.04.2013. Kjo deklaratë konformiteti, vërteton që produktet që do të lëvrohen plotësojnë kërkesat cilësore në raport me standardet CE të konformitetit për këto produkte duke marrë në konsideratë moshën e fëmijëve që do të përdorin këto artikuj, si dhe legjislacionin përkatës të sipërpërmendur. Nëpërmjet deklaratës së konformitetit, AK sigurohet për cilësinë e materialit të përdorur për krijimin e lodrave duke shmangur rrezikun e lëndëve toksike, dmëntimit të shëndetit nga përdorimi dhe risqet e gëlltitjes (mbytjes).*

2.4.3 Ditën e hapjes së tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një mostër sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor dhe sipas deklaratës së konformitetit të depozituar në SPE sipas kriterit 2.4.2.

Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Bashkisë Durrës, Sheshi “Liria”, lagjja 3, Durrës.

Në secilën lodër duhet të jetë qartazi i dukshëm markimi “CE”.

Çdo artikull duhet të jetë i ambalazhuar në ambalazh të personalizuar, në të cilët duhet të duken qartazi emri dhe adresa e prodhuesit.

Në ambalazhin e secilit artikull duhet të jetë etikimi në gjuhën shqipe për:

- Emërtimin e produktit/artikullit.
- Përshkrim i shkurtër i mënyrës së përdorimit.
- Materiali përbërës i artikullit
- Mosha e këshilluar për përdorim.
- Vendi i origjinës

Etiketat e vendosura dhe instruksionet e përdorimit që shoqërojnë artikujt, duhet të tërheqin vëmendjen e përdorueseve ose mbikëqyrësve të tyre mbi rreziqet dhe risqet e mundshme të dëmtimit që përfshihen gjatë përdorimit të lodrave si dhe mënyrat mbi shmangiet e rreziqeve dhe risqeve të tilla.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë gjithashtu një etiketë identifikuese të ngjitur, për efekt të procedurës së prokurimit, e cila të përmbajë të dhënat:

- Mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik. Etiketa e ngjitur nuk duhet të mbulojë të dhënat e kërkuara më sipër.

Mos paraqitja mostrave të kërkuara në vendin, ditën dhe orën e hapjes së ofertave për të gjithë mallrat objekt prokurimi është kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e AK për paraqitjen e mostrës për secilën lodër është vendosur referuar nenit 40 pika 6 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar. Për arsye se sasia e kërkuar për secilin artikull është shumë e madhe, AK ka çmuar të domosdoshme paraqitjen e mostrës. Mostra i shërben autoriteti kontraktor për tu siguruar për përmbushjen e specifikimeve teknike për secilin artikull, si dhe për tu siguruar për lidhjen e lodrës me deklaratën e konformitetit të depozituar në SPE.

Në lidhje me kërkesën që në mostër të jetë i dukshëm markimi CE, kjo kërkesë është vendosur referuar përcaktimeve në VKM nr. 262 datë 03.04.2013, si dhe direktivës së BE nr. 2009/48/EC, e përditësuar. Referuar kësaj direktive markimi CE (European Conformity) tregon përputhjen e lodrës me standardet e shëndetit dhe të sigurisë të përcaktuara nga Komiteti Europian.

Në lidhje me kërkesën për etiketimin në gjuhën shqipe, ku të dallohen qartë të dhënat e lodrës dhe prodhuesi, kjo kërkesë është vendosur referuar VKM nr. 262 datë 03.04.2013 “Për miratimin e rregullit

teknik për sigurinë e lodrave”, gjithashtu AK kërkon të identifikojë prodhuesin me qëllim kryerjen e çdo verifikimi që do të jetë i nevojshëm me katalog apo website të tjera për tu siguruar për cilësinë e lodrave.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

IV. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike për llojet dhe format e mjeteve didaktike për kopshtet e Durrësit, grupmoshave për të cilat do të përdoren ato janë hartuar nga ekspert të fushës, psikolog, punonjës social dhe monitoruesit e shërbimit në kopshte. Në kuadër të aktivitetit ditor të fëmijëve, në kopshtet publike, nisur edhe nga përvoja të mëparshme, janë parashikuar blerje të artikujve të mësipërm me qëllim nxitjen e zhvillimit të fëmijëve sipas grupmoshës, konkretisht nxitjen e zhvillimit motorrik (global dhe fin), zhvillimin gjuhësor dhe komunikimit, zhvillimin social-emocional dhe qasjen ndaj të nxënës.

Hartimi i specifikimeve teknike është bazuar gjithashtu në:

- Ligjin nr. 10 480, datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, të ndryshuar;
- Ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar;
- VKM-në nr. 262, datë 03.04.2013, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për sigurinë e lodrave’”;
- Ligjin nr. 27/2016, datë 17.03.2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, të ndryshuar.

Për përcaktimin e specifikimeve janë patur parasysh plotësimi i Kërkesave Thelbësore të Sigurisë:

Kërkesat e përgjithshme të sigurisë

Mjetet didaktike nuk duhet të rrezikojnë sigurinë ose shëndetin e përdoruesve ose palëve të treta kur ato përdoren siç është përcaktuar ose në mënyrën e parashikuar, duke pasur parasysh edhe sjelljen e fëmijëve (sidomos në rastin e grupmoshës 3 vjeç deri në 6 vjeç)

Kërkesat e veçanta të sigurisë

1. Karakteristikat Fizike dhe Mekanike -të jenë të qëndrueshme, mos të kenë pjesë të vogla;
2. Ndezshmëria - të mos ndizen, nëse ekspozohen ndaj flakës të japin një përhapje të ulet të flakës;
3. Higjiena - të shmanget risku ndaj infektimit, të mundësohet larja;
4. Pjesët e mprehta, të ngriturat, kontakti me to të jenë të reduktuara sa më shumë;
5. Nuk duhet të paraqesin risk lidhur me mbytjen, gëlltitjen nga pjesët e vogla;
6. Ndërtimi i mjeteve apo pjesët e mjeteve duhet të kenë përmasa të përshtatshme të pacoptueshme në varësi të moshës së përdorimit;
7. Të reduktojnë mundësisht sa më shumë riskun e shtypjes ose të kapjes të pjesëve të trupit, të rrobave dhe veshjeve, përplasjeve dhe mbytjes. etj

Argumentim i specifikimeve teknike:

I. ZHVILLIMI I AFTËSIVE MANIPULUESE (KONSTRUKSIONE)

1. Konstruksion druri me kunj e numra etj

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Përmasat, numri i elementeve dhe forma e kunjave janë përcaktuar duke iu referuar grupmohës së fëmijëve dhe përdorimit mbi tavolinë ose në këndin e lojës. Materiali prej druri duhet të jetë i përpunuar mirë, me sipërfaqe të lëmuar, pa ashkla, çarje ose skaje të mprehta. Elementet duhet të kenë përmasa të përshtatshme për kapje dhe manipulim të sigurt, ndërsa ngjyrat dhe shenjat numerike duhet të jenë të dallueshme.

Qëllimi i përdorimit: Artikulli ndihmon në zhvillimin e motorikës fine, koordinimit sy-dorë dhe kontrollit të lëvizjeve gjatë vendosjes së kunjave. Kombinimi i numrave me veprimtarinë manipuluese mbështet njohjen e sasive, renditjen, klasifikimin, përqendrimin dhe zgjidhjen e problemeve të thjeshta përmes lojës.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 129 komplete është shpërndarë në 12 kopshtet përfituese, me nga 5 deri në 25 komplete për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

2. Tapet formues per dysheme

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Përmasat dhe trashësia e elementeve janë përcaktuar për përdorim në dysheme dhe për krijimin e një sipërfaqeje të qëndrueshme loje. Materiali duhet të jetë i butë, rezistent, i larë ose lehtësisht i pastrueshëm, pa skaje të forta dhe pa pjesë që shpëputen lehtë. Sistemi i bashkimit duhet të mundësojë montim e çmontim të përsëritur pa krijuar hapësira ose ngritje që mund të shkaktojnë pengim.

Qëllimi i përdorimit: Tapeti formues krijon një zonë të sigurt për lojëra në dysheme, veprimtari motorike dhe ndërtim modelesh. Bashkimi i pjesëve zhvillon perceptimin hapësinor, dallimin e ngjyrave dhe formave, koordinimin dhe aftësinë për të krijuar struktura të thjeshta individualisht ose në grup.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 54 komplete është shpërndarë në 12 kopshtet përfituese, me nga 4 deri në 6 komplete për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

3. Konstruksion druri me forma gjeometrike

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Format gjeometrike dhe baza mbajtëse janë përcaktuar në përmasa të përshtatshme për duart e fëmijëve dhe për përdorim të sigurt. Druri duhet të jetë i lëmuar, rezistent dhe pa cepa të mprehtë; ngjyrat duhet të jenë të qarta dhe të dallueshme. Elementet duhet të përshtaten mirë me njëri-tjetrin, pa qenë tepër të vegjël ose të vështirë për t'u manipuluar.

Qëllimi i përdorimit: Konstruksioni ndihmon fëmijët të njohin dhe të krahasojnë format gjeometrike, madhësitë dhe ngjyrat. Vendosja, kombinimi dhe renditja e pjesëve zhvillojnë motorikën fine, orientimin hapësinor, të menduarit logjik, kreativitetin dhe aftësinë për të zgjidhur probleme gjatë ndërtimit.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 129 komplete është shpërndarë në 12 kopshtet përfituese, me nga 8 deri në 18 komplete për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

4. Komplet me kafshe te buta shtepiake dhe të fermës

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Figurat janë kërkuar me material të butë dhe të qëndrueshëm, të përshtatshëm për prekjen dhe manipulimin nga fëmijët. Përmasat duhet të shmangin rrezikun e gëlltitjes, ndërsa sipërfaqet duhet të jenë të pastrueshme, pa pjesë të forta, të mprehta

ose që shkëputen lehtë. Paraqitja duhet të jetë e qartë dhe e dallueshme për identifikimin e kafshëve shtëpiake dhe të fermës.

Qëllimi i përdorimit: Komploti përdoret për njohjen e kafshëve, habitatit, ushqimit dhe dobisë së tyre, si dhe për pasurimin e fjalorit. Loja me figura nxit tregimin, klasifikimin, imitimin e tingujve, imagjinatën dhe zhvillimin social përmes krijimit të situatave të jetës në shtëpi dhe në fermë.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 82 komplete është shpërndarë në 12 kopshtet përfituese, me nga 4 deri në 12 komplete për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

5. Komplot me kafshe te egra pylli

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Figurat e kafshëve të egra janë kërkuar me material të butë, të qëndrueshëm dhe të lehtë për t'u pastruar. Përmasat dhe ndërtimi duhet të jenë të përshtatshme për grupmoshën, pa skaje të mprehta ose elemente të vogla të shkëputshme. Format dhe ngjyrat duhet të mundësojnë dallimin e llojeve kryesore të kafshëve të pyllit.

Qëllimi i përdorimit: Artikulli shërben për njohjen e botës së kafshëve të egra, mjedisit ku jetojnë dhe dallimeve ndërmjet tyre. Përdorimi në biseda dhe lojëra tematike zhvillon fjalorin, kujtesën, klasifikimin, imagjinatën dhe ndërgjegjësimin fillestar për natyrën dhe mbrojtjen e saj.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 82 komplete është shpërndarë në 12 kopshtet përfituese, me nga 4 deri në 12 komplete për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

2. ZHVILLIMI I LEXIMIT DHE SHKRIMIT

1. Komplot druri me shkronja

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Shkronjat janë kërkuar prej druri të lëmuar, me përmasa që lejojnë kapje dhe vendosje të lehtë nga fëmijët. Shenjat grafike duhet të jenë të qarta, të lexueshme dhe të qëndrueshme ndaj përdorimit të përsëritur. Elementet nuk duhet të kenë cepa të mprehtë, ashkla ose pjesë të dëmtueshme dhe duhet të ruhen në mënyrë të organizuar.

Qëllimi i përdorimit: Komploti mbështet njohjen e alfabetit, dallimin e shkronjave, formimin e fjalëve të thjeshta dhe lidhjen ndërmjet tingullit dhe simbolit grafik. Manipulimi i shkronjave zhvillon motorikën fine, kujtesën vizuale, përqendrimin dhe përgatitjen graduale për lexim e shkrim.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 73 komplete është shpërndarë në 12 kopshtet përfituese, me nga 5 deri në 12 komplete për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

2. Tabela te ilustruara me mjetet e transportit

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Tabelat duhet të kenë ilustrime të qarta, me ngjyra të dallueshme dhe përmasa të përshtatshme për ekspozim në klasë. Materiali duhet të jetë rezistent ndaj përdorimit të shpeshtë, me sipërfaqe që pastrohet lehtë dhe pa skaje që dëmtohen ose krijojnë rrezik gjatë manipulimit. Përmbajtja vizuale duhet të paraqesë lloje të ndryshme transporti në mënyrë të kuptueshme për grupmoshën.

Qëllimi i përdorimit: Tabelat përdoren për njohjen, emërtimin dhe klasifikimin e mjeteve të transportit tokësor, detar dhe ajror. Ato pasurojnë fjalorin, nxisin përshkrimin dhe krahasimin, si dhe krijojnë mundësi për biseda mbi lëvizjen, udhëtimin dhe rregullat bazë të sigurisë rrugore.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 80 copë është shpërndarë në 12 kopshtet përfituese, me nga 4 deri në 12 copë për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

3. Tabela te ilustruara te alfabetit (shkronja shtypi)

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Tabela e alfabetit duhet të paraqesë shkronjat e shtypit qartë, me kontrast të mjaftueshëm dhe ilustrime të përshtatshme për moshën. Përmasat janë përcaktuar për shikueshmëri nga fëmijët në ambientin e klasës. Materiali duhet të jetë rezistent, i qëndrueshëm në ekspozim dhe i lehtë për t'u pastruar.

Qëllimi i përdorimit: Mjeti shërben si mbështetje e vazhdueshme vizuale për njohjen e shkronjave, rendin e alfabetit dhe lidhjen e shkronjës me figura e fjalë konkrete. Ai ndihmon kujtesën vizuale, shqiptimin, pasurimin e fjalorit dhe përgatitjen për veprimtaritë e para të leximit dhe shkrimit.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 82 copë është shpërndarë në 12 kopshtet përfituese, me nga 4 deri në 12 copë për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

4. Komplet me shkronja levizore.(36 elemente)

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Numri i elementeve është kërkuar për të mundësuar formimin e kombinimeve të ndryshme të shkronjave dhe fjalëve. Shkronjat duhet të jenë të qarta, të qëndrueshme dhe me përmasa të përshtatshme për manipulim të sigurt. Materiali dhe ngjyrat duhet t'i rezistojnë përdorimit të përsëritur, pa skaje të mprehta ose pjesë që dëmtohen lehtë.

Qëllimi i përdorimit: Shkronjat levizore mundësojnë të nxënit aktiv përmes renditjes, grupimit dhe formimit të rrokjeve e fjalëve të thjeshta. Përdorimi i tyre zhvillon ndërgjegjësimin fonologjik, kujtesën vizuale, motorikën fine, përqendrimin dhe aftësinë për të bashkëpunuar në veprimtari gjuhësore.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 108 komplete është shpërndarë në 12 kopshtet përfituese, me nga 8 deri në 12 komplete për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

5. Tabela te ilustruara me stinet e vitit,muajt,javet

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Tabelat janë kërkuar me ilustrime të qarta dhe renditje logjike të stinëve, muajve dhe ditëve të javës. Përmasat duhet të sigurojnë lexim dhe përdorim në grup, ndërsa materiali duhet të jetë rezistent ndaj ekspozimit e manipulimit të shpeshtë. Ngjyrat dhe simbolet duhet të ndihmojnë dallimin e periudhave kohore.

Qëllimi i përdorimit: Mjeti ndihmon në ndërtimin e koncepteve fillestare të kohës, rendit kronologjik dhe ndryshimeve sezonale. Fëmijët mësojnë të lidhin stinët me motin, veshjen dhe veprimtaritë përkatëse, si dhe të përdorin saktë emërtimet e muajve dhe ditëve të javës në komunikimin e përditshëm.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 84 copë është shpërndarë në 12 kopshtet përfituese, me nga 6 deri në 10 copë për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

6. Tabela te ilustruara pjeset e trupit te femijes

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Tabela duhet të paraqesë në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe të përshtatshme për moshën pjesët kryesore të trupit. Ilustrimet duhet të jenë të dallueshme, me emërtime të sakta dhe përmasa të përshtatshme për përdorim në klasë. Materiali duhet të jetë rezistent, i sigurt në manipulim dhe i lehtë për t'u pastruar.

Qëllimi i përdorimit: Artikulli shërben për njohjen dhe emërtimin e pjesëve të trupit, zhvillimin e vetëdijes trupore dhe pasurimin e fjalorit. Ai mbështet bisedat mbi funksionet bazë të trupit, higjienën, kujdesin personal dhe respektimin e kufijve truporë në një mënyrë të përshtatshme për fëmijët.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 106 copë është shpërndarë në 12 kopshtet përfutuese, me nga 8 deri në 12 copë për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

7. Tabela dyfaqeshe me peralla te ilustruara

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Tabela dyfaqëshe është kërkuar për të ofruar më shumë përmbajtje në të njëjtin mjet didaktik. Ilustrimet duhet të jenë të qarta, tërheqëse dhe të renditura në mënyrë që të mbështesin rrjedhën e tregimit. Materiali duhet të jetë i qëndrueshëm, me sipërfaqe të mbrojtur dhe skaje të sigurta për përdorim të përsëritur.

Qëllimi i përdorimit: Përrallat e ilustruara nxisin dëgjimin aktiv, kuptimin e tekstit, ritregimin dhe renditjen e ngjarjeve. Fëmijët zhvillojnë fjalorin, imagjinatën, kujtesën dhe aftësinë për të shprehur mendime e emocione, ndërsa përdorimi në grup mbështet diskutimin dhe komunikimin.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 91 copë është shpërndarë në 12 kopshtet përfutuese, me nga 4 deri në 12 copë për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

3. ZHVILLIMI I AFTËSIVE BASHKËPUNUESE DHE KRIJUESE

1. Komplet i veglave mjekesore

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Veglat imituese duhet të kenë forma të dallueshme, përmasa të përshtatshme dhe skaje të rrumbullakosura. Materiali duhet të jetë i sigurt, rezistent dhe i pastrueshëm, pa elemente të mprehta ose mekanizma që mund të shkaktojnë dëmtim. Kompleti duhet të mundësojë ruajtjen dhe organizimin e aksesorëve.

Qëllimi i përdorimit: Kompleti përdoret në lojëra me role ku fëmijët imitojnë mjekun, infermierin dhe pacientin. Kjo lojë zhvillon komunikimin, empatinë, bashkëpunimin dhe kujdesin ndaj tjetrit, si dhe ndihmon në zvogëlimin e ankthit ndaj kontrolleve mjekësore përmes njohjes së mjeteve dhe veprimeve bazë.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 103 komplete është shpërndarë në 12 kopshtet përfutuese, me nga 5 deri në 16 komplete për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

2. Komplet i veglave te marangozit & profesione etj

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Veglat imituese dhe pjesët shoqëruese duhet të jenë të lehta, të qëndrueshme dhe me skaje të rrumbullakosura. Përmasat duhet të

mundësojnë kapje të sigurt dhe veprime simbolike montimi, pa maja funksionale ose pjesë të rrezikshme. Komplet duhet të përfshijë elemente të mjaftueshme për lojë individuale dhe bashkëpunuese.

Qëllimi i përdorimit: Artikulli nxit lojën me role dhe njohjen e profesioneve, duke u dhënë fëmijëve mundësi të imitojnë veprime montimi e riparimi. Manipulimi i veglave zhvillon koordinimin sy-dorë, motorikën fine, të menduarit logjik dhe zgjidhjen e problemeve, ndërsa loja në grup forcon bashkëpunimin dhe respektimin e radhës.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 103 komplete është shpërndarë në 12 kopshtet përfituese, me nga 5 deri në 20 komplete për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

3. Komplet set guzhine. (sobe , tenxhere, pjata, etj)

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Elementet e kuzhinës lodër duhet të jenë të përshtatshme për grupmoshën, të lehta për t'u kapur dhe me skaje të rrumbullakosura. Materiali duhet të jetë rezistent, i pastrueshëm dhe pa pjesë të mprehta ose mekanizma nxehtësie. Numri dhe larmia e aksesorëve janë kërkuar për të mundësuar role e veprime të ndryshme gjatë lojës.

Qëllimi i përdorimit: Seti mbështet lojën imituese të gatimit, shtrimit të tryezës dhe organizimit të veprimtarive familjare. Fëmijët pasurojnë fjalorin, zhvillojnë imagjinatën, motorikën fine dhe rendin e veprimeve, ndërsa ndarja e roleve nxit komunikimin, bashkëpunimin dhe përgjegjësinë.

Argumentimi i sasisë dhe shpërndarjes: Sasia totale prej 108 komplete është shpërndarë në 12 kopshtet përfituese, me nga 5 deri në 18 komplete për institucion, sipas grafikut të shpërndarjes. Diferencimi i sasive lidhet me numrin e grupeve, intensitetin e përdorimit të artikullit dhe nevojat e evidentuara për secilin kopsht; për këtë arsye shpërndarja është funksionale dhe jo domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

4. Komplet me figura per te plotesuar

Argumentim mbi përmasat, materialin dhe karakteristikat teknike: Figurat duhet të kenë konture të qarta, nivel vështirësie të përshtatshëm për moshën dhe sipërfaqe të përshtatshme për plotësim ose manipulim sipas specifikimit teknik. Materiali duhet të jetë i sigurt, i qëndrueshëm dhe pa skaje të mprehta. Përmbajtja duhet të jetë e larmishme, pa elemente diskriminuese dhe e kuptueshme për fëmijët.

